

**AKT THEMELIMI
A-T-A CONSTRUCTION**

Sot ne dt.10/02/2022me cilesine e " Ortakeve Themelues ",

TAULANT DYRMISHI, i biri i Bardhyl i datelindjes 29/03/1986, i lindur neGramsh dhe banues neLagj.nr.17 ,rruga Vegjilharxhi ,Durres , shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjetpasaportes nderkombetare me Nr.BB0228228 ,leshuar nga MPB me date 29/06/2018,

ARDIAN MARKU, i biri i Gjergji datelindjes 10/02/1989, i lindur neShengjergjdhe banues ne Lagj.nr.16 rruga Abaz Celkupa ,Durres, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.036734659 ,leshuar nga MPB me date 16/12/2020,

AUREL LLESHAJ, i biri i Geg i datelindjes 14/03/1991, i lindur neRreshen dhe banues ne Lagj.nr.17 rruga Vinçens Prenushi,Durres, shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me Nr.036653060 ,leshuar nga MPB me date 20/11/2020,

te cilet me vullnet të lire të plote e të singerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **A-T-A CONSTRUCTION** shpk.

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja,Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **A-T-A CONSTRUCTION** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaket që përballojne humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne adresen:

Lagj.nr.14Nishtulla,Rruga Bajram Tusha,pasuria nr.20/338, godine dykateshe, Shkozet - Durres.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti i veprimtarise

- **Import-export ,perpunim ,montim dhe shitje me shumice e pakice te profileve te aluminit,hekurit,PVC,xhamit dhe veshjeve te jashtme te ndertesave me keto mteriale.**



- Importin , eksportin dhe tregetimin me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale , ushqimore , produkteve te ndryshme bujqesore , blegtorale e fruta perime , prodhimeve te detit , pije freskuese , te miellit e nenprodukteve te tij , te konfeksioneve e veshmbathjeve , pajisje elektroshtepiake ,kompjutera dhe pjeset e tjera te tyre , produkte higjenosanitare , hidraulike , prodhime qeramike artizanati, duralumini , mekanike te lendes drusore te perpunuar dhe te paperpunuar, lekures e nenprodukteve te saj , mobiljeve dhe materialeve te lendeve te para te te gjitha llojeve , materiale dhe lendeve te ndertimit , pllakat e llojeve dhe dimensioneve te ndryshme , materialeve plastike e nenprodukteve te tyre.
- Transport kombetar dhe nderkombetar tokesor te udhetareve, bagazheve dhe mallrave.
- Hapje farbrikash , ndertime hecesh ,prodhim dhe shitje energjie, hapje spitalesh, hapje te depove farmaceutike etj.
- Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektit te saj, duke perfshire edhe veprime per shitblerje sendesh te luajtshme dhe te paluajtshme, pjesemarrje me kuota dhe aksione ne shoqeri dhe ndermarrje te tjera.

Neni 5

Kohezqjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 6,798,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 6,798,000 leke i perbere nga 3 kuota dhe zoterohet nga ortakët e shoqerise si me poshte :

1. Ortaku Themelues: **TAULANT DYRMISHI**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 2,263,734 Leke, e cila perfaqeson 33.3 % te kapitalit te shoqerise,
2. Ortaku Themelues: **ARDIAN MARKU**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 2,263,734 Leke, e cila perfaqeson 33.3 % te kapitalit te shoqerise.
3. Ortaku Themelues: **AUREL LLESHAJ**, zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 2,270,532 Leke, e cila perfaqeson 33.4 % te kapitalit te shoqerise.

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte 6,798,000 Leke e cila do te derdhet ne te ardhmen nga ana e ortakeve te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortakët pergjigjen per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me miratimin e Asamblese se ortakeve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU II
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
Asambleja e ortakeve brenda nje afati prej gjashte muajsh, duke filluar nga data e mbylljes se vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit,te ortakeve pjesmarres,per ndryshimin e statutit,zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,shperndarjen e fitimeve,riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres,per çeshtje te tjera si:emerimin dhe shkarkimin e administratorëve,te likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar,percaktimin e shperblimeve,perfaqesimin e shoqerise ne gjykate.
Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR.

Neni 10

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga **z.Taulant Dyrmishi**
Emerimi i administratorit eshte me nje afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.
Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.
Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.
Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.
Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.
Administratori ose ortakut që nuk janë persona juridikë nuk u lejohe të kontraktojnë në çfarëdo forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkakut, edhe para plotesimit të afatit per të cilen eshte krijuar sic mund të jene a.Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.

c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.
Ne kete rast Asambleja e ortakeve merr vendim me shkrim ne të cillin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare **A-T-A** shpk, nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË

Alban Lleshi 

Adrian Marku 

Joullont Drem, Sti

